

VENDIM
Nr.106, datë 9.2.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRDITËSUAR TË MALLRAVE USHTARAKE DHE TË LISTËS SË MALLRAVE E TEKNOLOGJIVE, ME PËRDORIM TË DYFISHTË, QË I NËNSHTROHEN KONTROLLIT SHTETËROR TË IMPORT-EKSPORTEVE¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9707, datë 5.4.2007 “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së importit-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, përkatësisht, sipas shtojcave nr.1 e nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi, të cilat i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve.

2. Vendimi nr.1569, datë 19.11.2008 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror import-eksporteve”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

¹ CELEX nr.32009R0428 “Rregullorja e Këshillit nr.428/2009: “vendosja e një regjimi Komunitar mbi kontrollin e eksporteve, transferimeve, ndërmjetësimeve, tranziteve të mallrave me përdorim të dyfishtë”. Gazeta Zyrtare: OJ L 134, 29.5.2009

¹ CELEX nr.52010XG0318 “Lista e përbashkët Ushtarake e Bashkimit Europian”, Gazeta Zyrtare OJ C 69, 18.3.2010